



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit
të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë



Prishtinë, gusht 2023

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë” në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Fatlinda Ramosaj, Drejtor i departamentit

Ernes Beka (Udhëheqës i ekipit)

Armin Bushati (Anëtar ekipi).

¹ Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

² Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

³ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁴ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme.....	5
1. Hyrje.....	7
2. Objektiva e auditimit.....	8
Pyetjet e auditimit.....	8
3 Gjetjet e auditimit.....	9
3.1 Renovimet në Stadiumin Olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë.....	9
3.1.1 Mangësi në hartimin e projekteve ideore dhe kryesore.....	11
3.1.2 Procesi i shpronësimit ende në fazën fillestare.....	12
3.1.3 Mangësitë gjatë aplikimit dhe pajisjen me lejet e ndërtimit.....	14
3.1.4 Realizimi jo sipas planit dinamik.....	14
3.2 Faza e parë e renovimit të Stadiumit të Qytetit në Gjiilan.....	16
3.2.1 Mangësi në projektin ideor dhe kryesor.....	16
3.2.3 Ndryshime të konsiderueshme në disa pozicione të kontratës.....	19
3.2.4 Oferta fituese më e shtrenjtë në realizim se ofertat tjera pas amendamentimit të kontratës.....	21
3.3. Faza e parë për renovimin e Stadiumit të Qytetit në Gjakovë.....	22
3.3.1 Projekti nuk i plotëson kriteret për stadium të kategorisë së katërt.....	22
3.3.2 Refuzimi i kërkesës për kushte ndërtimore në mungesë të dokumentacionit.....	24
3.3.3 Realizimi i planit dinamik jo i kënaqshëm.....	24
3.4 Përdorimi shumë i shpeshtë i procedurave të negociuara të prokurimit nga MKRS.....	25
3.4.1 Arsytimi i paqëndrueshëm i kriterit për përdorim të procedurës së negociuar.....	25
3.4.2 Vazhdim i përdorimit të procedurës së negociuar edhe për kontratën për punë mbikëqyrëse.....	27
3.4.3 Hulumtimi i tregut.....	28
3.5 Mangësi tjera që kanë përcjellë proceset administrative.....	29
3.5.1 Zyrtar i njëjtë caktohet anëtar i komisionit të vlerësimit si dhe menaxher i kontratës... ..	29
3.5.2 Mos ri-konfirmimi i informatave financiare në Deklaratën e Nevojave.....	29
3.5.3 Projektet për investime kapitale ishin ndesh me njëra tjetrën.....	30
4 Konkluzionet.....	31
5 Rekomandimet.....	34
Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia ..	35
Kriteret e auditimit:.....	36
Metodologjia e Auditimit.....	37
Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant.....	39
Shtojca 2. Letër konfirmimet.....	42

Lista e Shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
FFK	Federata e Futbollit të Kosovës
FIFA	Fédération Internationale de Football Association
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
MMPHI	Ministria Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
OE	Operator Ekonomik
UEFA	Union of European Football Associations
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Infrastruktura sportive adekuate është kushti themelor për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve sportive si dhe ngritjen e sportit në nivelin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare. Infrastruktura ka ndikim pozitiv në pjesëmarrje më aktive në sport e që si rezultat ka përmirësimin e shëndetit, produktivitetit dhe mirëqenien e të rinjve të cilët merren me sport. Përgjegjës për të krijuar kushte për aktivitete sportive, janë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe komunat e Republikës së Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin “Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë”. Ky auditim ka vlerësuar nëse Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve së bashku me Komunat e Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës ishin efikase në menaxhimin e projekteve për renovimin/rikonfigurimin e stadiumeve. Po ashtu, auditimi ka vlerësuar edhe procesin e prokurimit të këtyre projekteve, nëse janë arritur qëllimet e përcaktuara si dhe a janë përfunduar me kohë dhe sipas standardeve të kërkuara.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve së bashku me Komunat Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë nuk ishin treguar efikase në menaxhimin e renovimit/rikonfigurimit të stadiumeve. Qëllimet e synuara për renovimin dhe rikonfigurimin e stadiumeve nuk janë arritur, vonesat janë të theksuara dhe si rrjedhojë këto projekte mund të mos përfundojnë plotësisht dhe të mos funksionalizohen brenda një afati optimal kohorë. Kjo kishte ndodhur për arsye se nuk ishin siguruar parakushtet e nevojshme me kohë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Komunat Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë nuk kanë arritur qëllimet e përcaktuara për renovimin dhe rikonfigurimin e stadiumeve. Pavarësisht se kanë kaluar disa vite (nga katër e deri në shtatë) që nga fillimi i procesit, stadiumet janë ende larg përfundimit dhe funksionalizimit. Kjo mungesë e progresit dhe mos kompletimit të stadiumeve paraqesin rrezik për Kombëtaren e Kosovës dhe klubet sportive, pasi ato mund të detyrohen që ndeshjet ndërkombëtare t'i zhvillojnë në shtetet fqinje apo në rastin më të keq mund ti humbin ndeshjet me rezultat zyrtar.

Probleme të theksuara janë shfaqur me projektet ideore për renovimin e stadiumeve. Në rastin e Stadiumit Olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë, projekti ideor është miratuar nga UEFA por nuk është hartuar në kohën e duhur. Kjo ka penguar identifikimin dhe shpronësimin e pronave që janë të nevojshme për vazhdimin e projektit si parakusht për marrjen e lejeve të ndërtimit.

Për më tepër, projekti ideor dhe kryesor për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjilan nuk është dorëzuar në UEFA, dhe nuk është kategorizuar sipas udhëzuesëve të UEFA-s për infrastrukturën dhe cilësinë e stadiumit. Kjo mungesë kategorizimi dhe referimi në udhëzuesit e UEFA-s mund të çojë në infrastrukturë dhe cilësi nën nivelin e kërkuar. Po ashtu, në komunën e Gjakovës fillimisht është hartuar projekti për stadiumin e qytetit për t'u klasifikuar si stadium i kategorisë së katërt sipas udhëzimeve të UEFA-s. Megjithatë, për

shkak të dokumentacionit të pamjaftueshëm, nuk kishte arritur të siguroj kushtet ndërtimore, duke rezultuar me uljen e kategorisë së stadiumit nga niveli i katërt në kategorinë e tretë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komuna e Gjilanit nuk kanë ndjekur procedurat e duhura të prokurimit duke cenuar transparencën dhe konkurrencën në proceset e prokurimit.

Komuna e Gjilanit ka bërë ndryshime substanciale në kontratën për renovimin e stadiumit pa i ndjekur hapat e nevojshëm për ri-dizajnimin apo ndryshimin e projektit. Në vend të kësaj, ndryshimet u bënë duke amandamentuar kontratën ekzistuese. Sipas kritereve ligjore, ndryshimet thelbësore në kontratë kërkojnë një projekt të ri dhe një procedurë të re prokurimi. Në rastin e Gjilanit, ku janë bërë ndryshime deri në 755% në pozicione të caktuara, ky amandamentim i kontratës i ka kushtuar komunës 219,680€ më shumë për këto pozicione.

Mos realizimi i punimeve sipas kontratës dhe planit dinamik ka rezultuar me vonesa të dukshme në përfundimin e projekteve për renovimin e stadioneve si dhe funksionalizimin e tyre. Duke marrë parasysh intensitetin aktual të punës, ekziston shqetësimi se këto projekte nuk do të përfundojnë plotësisht dhe nuk do të funksionalizohen brenda një afati optimal kohorë. Po ashtu, kontrata për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjilan është ndërprerë, duke e përkeqësuar situatën.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka arsyetuar përdorimin e procedurave me negociim në tre raste të prokurimit. Rastet e urgjencës ose të drejtat e autorit ishin arsye të pamjaftueshme për përdorimin e procedurave të negociuara, pasi renovimi i stadiumit nuk mund të klasifikohet si një emergjencë ekstreme ose një çështje e të drejtës së autorit. Procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë do të duhej të përdoren si burim i fundit meqë nuk sigurojnë transparencë dhe konkurrencë sa procedura e hapur.

Për të siguruar se projektet që zhvillon Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe Komunitet Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë, zbatohen në përputhje me kërkesat rregullative, përfundohen me kohë dhe vihen në dispozicion të Kombëtares dhe klubeve sportive, ne kemi dhënë nëntë rekomandime. Lista e plotë e rekomandimeve është paraqitur në kapitullin pesë të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit së bashku me Komunitet Mitrovicë, Gjilanit dhe Gjakovës janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna. Inkurajojmë institucionet e përfshira në këtë auditim që t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet.

1. Hyrje

Sporti në Kosovë për një kohë të gjatë ka qenë në pozitë të marginalizuar, i lënë anash mes tjerash edhe për shkak të mungesës së pranimit në nivele ndërkombëtare, si rrjedhojë e kësaj me vite të tëra nuk kishte investime në infrastrukturë.

Në vitin 2018, pas insistimeve të vazhdueshme nga Union of European Football Associations (UEFA), Fédération Internationale de Football Association (FIFA), Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) investuan në renovimin e stadiumit kryesorë të Prishtinës ‘‘Fadil Vokrri’’. Pas këtyre investimeve stadiumi tani përmbush kriteret e përcaktuara nga UEFA/FIFA për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare të përfaqësueseve/kombëtareve si dhe të klubeve të Kosovës. Ky është stadiumi i vetëm në Kosovë i cili i përmbush kriteret dhe është tejet i ngarkuar, pasi që të gjitha ndeshjet me karakter ndërkombëtar zhvillohen aty. Si rezultat i kësaj, stadiumi rrezikon që të humb licencën nga UEFA/FIFA me ç’rast kombëtalet dhe klubet do të detyrohen të gjejnë zgjidhje jashtë vendit.

Mungesa e infrastrukturës në sport ka ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin e sportit, sportistëve dhe në vazhdimësi të rezultateve në arenën ndërkombëtare. Në aspektin e jetës aktive dhe identifikimit të hershëm të talentëve sportiv, ndërlidhja e edukimit sportiv në shkolla, sporteve amatore dhe atyre rekreative është e nevojshme për zhvillimin në të ardhmen.

Një nga elementët kryesor për masivizimin dhe ngritjen e cilësisë së sportit është numri dhe funksionaliteti i objekteve të sportit.

Marrë parasysh këtë, çështja e infrastrukturës së stadiumeve në Kosovë është një ndër temat më të prekshme tash e disa vite sidomos pas pranimit të sporteve në arenën ndërkombëtare.

Ngritja e cilësisë së sportit e në veçanti të futbollit në Kosovë ndërlidhet me përmirësimin e kushteve të nevojshme për të ushtruar aktivitete sportive e cila përkon edhe me përmirësimin e objekteve sportive. Ky përmirësim i cilësisë arrihet me ndërtimin e infrastrukturës së re, si dhe renovimin dhe modernizimin e infrastrukturës ekzistuese sportive.

Sidoqoftë, edhe pse viteve të fundit janë bërë disa investime, gjendja e infrastrukturës sportive lë hapësirë për përmirësim për të arritur nivelin e dëshiruar.

Ndërtimi i infrastrukturës sportive/stadiumeve të futbollit në Kosovë kryesisht financohet nga buxheti i shtetit, mirëpo ka raste kur financohet edhe nga Federata e Futbollit të Kosovës në bashkëpunim me UEFA dhe FIFA përmes programeve të tyre të veçanta për zhvillim të sportit, siç është FIFA Forward programme⁵.

⁵ <https://www.fifa.com/football-development/fifa-forward>

Përfundimi i projekteve me kohë, brenda limiteve buxhetore dhe me cilësi të mirë është i rëndësishëm si për mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive të futbollit ashtu edhe për zhvillimin e mirëqenies në shoqërinë tonë.

Një infrastrukturë sportive cilësore, e ndërtuar në kohë reale do t'iu ndihmonte sportistëve të Kosovës të jenë më të përgatitur dhe më konkurrues në nivel ndërkombëtar në mënyrë që të garojnë në nivel të barabartë me sportistët e vendeve tjera. Po ashtu, do të mundësonte zhvillimin e më shumë ndeshjeve ndërkombëtare në vendin tonë me ç'rast do të vijnë tifoz nga vende të ndryshme e cila do të ndikonte në rritjen dhe zhvillimin e hotelierisë dhe turizmit. Kjo do të kishte ndikim edhe në rritjen e GDP-së në vendin tonë, pasi që sipas hulumtimeve ndërkombëtare industria e sportit kontribuon në rritje të GDP-së në nivel global me 1%⁶ në baza vjetore.

2. Objektiva e auditimit

Përmes këtij auditimi kemi vlerësuar nëse MKRS së bashku me Komunitet e Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës ishin efikase në menaxhimin e projekteve për renovimin/rikonfigurimin e stadioneve. Po ashtu, auditimi ka vlerësuar edhe procesin e prokurimit të këtyre projekteve, nëse janë arritur qëllimet e përcaktuara për renovimin/rikonfigurimin e stadioneve, si dhe nëse janë përfunduar me kohë dhe sipas standardeve të kërkuara.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit, kemi formuluar pyetjet në vijim:

1. Sa ishin efikase Ministria dhe Komunitet në renovimin/rikonfigurimin e stadioneve?
2. A është zhvilluar procesi i prokurimit në mënyrë të duhur?
3. A është bërë menaxhimi dhe monitorimi i projekteve sipas kushteve të kontraktuara?

Ky auditim ka mbuluar tri projekte të renovimit/rikonfigurimit të stadioneve. Kontratat për këto projekte ishin lidhur gjatë viteve 2017-2019. Këto tri projekte të renovimit të stadioneve i takojnë kategorisë së katërt të stadioneve në bazë të Udhëzuesit të UEFA-së e që nënkupton se këto stadione kanë kapacitet më të madh dhe se në momentin e licencimit, në to mund të zhvillohen ndeshje ndërkombëtare të klubeve dhe kombëtareve të Kosovës. Përzgjedhja është bërë edhe duke përfshirë shpenzimet dhe shumën e kontraktuar në autoritetet kontraktuese përkatëse. Aktualisht këto janë stadiumet e vetme të kësaj kategorie që janë duke u realizuar në Kosovë.

Metodologjia e detajuar e aplikuar gjatë këtij auditimi, nën-pyetjet e auditimit kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën I.


⁶ <https://www.uwi.edu/uop/sites/uop/files/Value%20and%20benefits%20of%20the%20Sport%20Industry.pdf>

3 Gjetjet e auditimit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) së bashku me komunat kishte lidhur kontrata për renovimin e tri stadioneve vlera e përgjithshme e të cilave ishte 16.7 milion euro. Vlera e kontratës e lidhur me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për stadiumin olimpik “Adem Jashari” ishte rreth 12.5 milion euro, ndërsa vlera e kontratave për dy stadiumet tjera (Gjilan dhe Gjakovë për fazën e parë) të lidhura me procedurë të hapur ishte rreth 4.2 milion euro.

Për renovimin e këtyre tri stadioneve që janë pjesë e mostrës, që nga nënshkrimi i kontratës deri në periudhën sa ne ishim në fazën e ekzekutimit⁷ MKRS-ja kishte shpenzuar rreth 5.6 milion euro kundrejt 16.7 milion euro sa ishin të kontraktuara.

Grafiku 1 Raporti në përqindje ndërmjet kontraktimit dhe shpenzimeve për renovimin/ndërtimin e stadioneve në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë



Siç shihet në grafik, shpenzimet e realizuara për renovimin e stadiumit “Adem Jashari” në Mitrovicë janë vetëm 24% e vlerës së kontraktuar, ndërsa për stadiumin në Gjakovë ishin shpenzuar 28% të vlerës të kontraktuar. Më mirë në këtë drejtim qëndron Stadiumi i Gjilanit me realizim të shpenzimeve në raport me vlerën e kontraktuar e cila kishte arritur 71% të vlerës së kontraktuar. Të gjitha këto shpenzime përkojnë edhe me punimet e realizuara.

3.1 Renovimet në Stadiumin Olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë

Stadiumi olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë është stadium me karakter olimpik dhe me kapacitetin më të madh të ulëseve në Kosovë. Ky stadium ishte ndërtuar në vitet e 80-ta dhe në disa raste kishte shërbyer për lojëra ndërkombëtare.

Në vitin 2014, MKRS-ja kishte investuar 740 mijë euro nga buxheti i shtetit në këtë stadium. Në mungesë të mirëmbajtjes, për një kohë të shkurtë stadiumi ishte dëmtuar dukshëm. Si pasojë e këtij dëmtimi, në vitin 2017 ishin investuar edhe 1.5 milion euro, prej të cilave 700 mijë euro për reflektorë ishin ndarë nga Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) dhe pjesa tjetër

⁷ Pagesat e realizuara deri në muajin mars të vitit 2023

nga MKRS-ja. Me këto investime për renovim ishte mundësuar që ky stadium të certifikohet për kategorinë e dytë sipas kriterëve të parapara me Udhëzues të UEFA-së.

Foto 1 Stadiumi olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë



Fotoja më lart paraqet gjendjen e stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë pas investimeve të ndërmarra nga MKRS-ja (2014 -2017) në bashkëpunim me FFK-në pas të cilave stadiumi ishte certifikuar për kategori të nivelit të dytë sipas udhëzuesit të UEFA-së.

Inspektori i UEFA-së në nëntor të vitit 2018 kishte hartuar një raport ku kishte rekomanduar FFK-në të fillojë me planifikim dhe trajtim të çështjeve që lidhen me renovimin apo rindërtimin e një stadiumi tjetër.

Sipas inspektorit, marrë parasysh investimin domethënës që ishte bërë në stadiumin olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë (2014-2017) i cili në atë kohë plotësonte kërkesat e UEFA-së për kategorinë e dytë, përmirësimi i infrastrukturës në këtë stadium mund të ishte opsioni më i përshtatshëm dhe më pak i kushtueshëm për Kosovën. Në këtë mënyrë Kosova do t'i ketë të paktën dy stadione të kategorisë së katërt sipas standardeve të UEFA-së, ku do të mund të organizoheshin ndeshje ndërkombëtare për klube e kombëtare dhe të zvogëlohej ngarkesa e ndeshjeve në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Duke u nisur nga gjithë kjo, me kërkesë të FFK-së dhe rekomandimet e inspektorit të UEFA-së, MKRS-ja, (Departamenti i sportit) në fund të dhjetorit të vitit 2018 kishte filluar procedurat për renovimin e "tretë" të stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë.

3.1.1 Mangësi në hartimin e projekteve ideore dhe kryesore

Projektet ideore si dhe kryesore duhet të hartohen para publikimit të njoftimit për kontratë konform kërkesave të ligjit për ndërtim si dhe udhëzuesit të UEFA-së për cilësi në stadiume

Përveç kërkesave të ligjit për ndërtim edhe Udhëzuesi i UEFA-së për cilësi në stadiume⁸ shumë qartë parasheh rrugën që duhet ndjekur ndërtuesi/investitori lidhur me ndërtimin/renovimin e një stadiumi. Në pikën A:9 të këtij udhëzuesi paraqiten qartë shtatë faza të pavarura nga njëra tjetra përfshirë afatet kohore të cilat duhet ndjekur në mënyrë që një projekt i tillë i ndërtimit/renovimit të stadiumit të përfundojë në mënyrën sa më të mirë. Hartimi i projektit ideor sipas udhëzuesit bën pjesë në fazën e dytë e cila i paraprinë procesit të prokurimit e që është pjesë e fazës së katërt.

MKRS-ja kishte vendosur të përdorë kushtet e Federatës Ndërkombëtare të Inxhinierëve dhe Konsulentëve (FIDIC) *Silver Book* apo "*Projekto - Ndërto*" për realizimin e kontratës për renovim të Stadiumit Olimpik "*Adem Jashari*" në Mitrovicë. Këto kushte përdoren në industrinë e ndërtimit dhe inxhinierisë për projekte komplekse. Përveç këtyre kushteve, MKRS-ja në kontratë kishte përfshirë edhe kriteret që rrjedhin nga udhëzuesit e UEFA-së, me fokus ato që lidhen me infrastrukturën dhe cilësinë në stadiume.

Metodologjia të cilën e kishte përdorur MKRS-ja (kushtet e FIDIC-ut *Silver Book* - "*Projekto-ndërto*") duke inkorporuar të gjitha fazat në një kontratë përfshirë edhe hartimin e projektit, që zakonisht përdoret në projekte të vogla dhe të mesme dhe jo për projekte komplekse siç ishte ky stadium, nuk rezultoi të ishte metodë e përshtatshme për këtë kontratë.

Kontratën për renovimin e stadiumit të nënshkruar në muajin qershor të vitit 2019, MKRS-ja e kishte dizajnuar në atë mënyrë ku kishte inkorporuar pesë fazat (nga koncepti deri te realizimi) të parapara me Udhëzues të UEFA-së në një kontratë të vetme bazë dhe nuk i kishte trajtuar si faza të pavarura/ndara.

Vlen të theksohet se MKRS-ja së bashku me përfaqësues të OE-së në fillim të dhjetorit të vitit 2019 kishin diskutuar projektin ideor me përfaqësues të UEFA-së, të cilët e kishin vlerësuar se ky projekt ideor i plotëson kriteret për stadium të kategorisë së katërt me disa rekomandime të cilat duhet të merren parasysh gjatë realizimit të renovimit të stadiumit olimpik "*Adem Jashari*" në Mitrovicë.

⁸ https://editorial.uefa.com/resources/01f9-0f842793b513-3ec14e88e0ef-1000/uefa_guide_to_quality_stadiums.pdf

Foto 2 Projekti ideor për stadiumin olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë



Projekti ideor ishte hartuar brenda afatit prej gjashtë muaj sipas kërkesave të udhëzuesit të UEFA-së. Mirëpo siç e kemi cekur më lartë, projekti ishte hartuar si pjesë e kontratës bazë për renovim të stadiumit dhe nuk ishte përgatitur para fazës së njoftimit për kontratë lidhur me renovimin e stadiumit. Përveç kësaj, koha kur ishte përgatitur projekti ideor nuk përkon me kohën kur MKRS-ja do të duhej të përgatiste dokumentacionin teknik.

Përdorimi i kushteve të FIDIC-ut të cilat kishin paraparë përfshirjen e projektit ideor në kontratën bazë të renovimit të stadiumit ishte bërë me idenë që kjo është metoda më e përshtatshme për realizimin e këtij projekti. Për shkak se projekti ideor nuk ishte hartuar në fazën e duhur, kjo kishte shkaktuar vonesa edhe në parashtrimin e kërkesës fillimisht për kushte ndërtimore e më pas edhe për leje ndërtimore.


3.1.2 Procesi i shpronësimit ende në fazën fillestare

Plani dinamik për renovim/rikonfigurim deri te vënia në funksion të stadiumit duhet të përfshijë një sërë aktiviteteve ose veprime paraprake. Të gjitha dokumentet relevante (lejet ndërtimore, mjedisore, elaboratet për shpronësim, certifikata e sigurisë në punë, etj.) të cilat ndërlidhen me fillimin e punës ndërtimore duhet të kompletohen me kohë në mënyrë që mos të shfaqen pengesa të panevojshme gjatë realizimit të punimeve.

UA për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës thekson “Kur bashkimi i parcelave bëhet për qëllim të ndërtimit, para se të merret leja e ndërtimit investitori obligohet që paraprakisht të krijoj gjenden juridike dhe kadastrale sipas planit urbanistik” si dhe “Çdo parcelë e re e krijuar me ndarje ose bashkim merr numër të ri kadastral”.

MKRS-ja nuk kishte qenë në dijeni që stadiumi olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë, nuk kishte një titullar të vetëm të pronës. Stadiumi ishte ndërtuar në disa prona të cilat kryesisht i përkisnin kompanive në kuadër të Ndërmarrjes “Trepça”.

Foto 3 Pronat brenda dhe rreth stadiumit olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë



Për të plotësuar kriteret për kategorinë e katërt të UEFA-së, stadiumi duhet të zgjerohet dhe ky zgjerim prekë 35 parcela. Për parcelat të cilat ishin brenda stadiumit, Komuna e Mitrovicës kishte bërë bashkimin e tyre në një parcelë të vetme me ç’rast kishte ndryshuar edhe numri i parcelës (shih foto 5 pjesa e stadiumit e nënvizuar me ngjyrë të kuqe).

Sipas Drejtorisë së Urbanizmit në Komunë të Mitrovicës, për parcelat tjera rreth stadiumit, në periudhën e parë të vitit 2023 kishte ndërmarrë hapa në bashkëpunim me përfaqësuesit e ndërmarrjes Sh.A Trepça për të përmbyllur çështjen e bashkimit të pronave të mbetura në një titullar në mënyrë që t’i mundësohet MKRS-së të përmbush kriterin për shpronësim.

Pas këtij hapi, MKRS-ja duhet ta përgatisë elaboratin e ri të shpronësimit dhe pas përmbylljes së procesit të shpronësimit mund të vazhdojë me procedura për t’u pajisur me kushte ndërtimore në MMPHI.

Mungesa e njohurive për kriteret dhe procedura rreth pajisjes me leje ndërtimore si dhe fillimi me vonësë i komunikimit me Komunën e Mitrovicës për çështjen e pronave (pas nënshkrimit të kontratës), ka rezultuar në një situatë ku MKRS-ja duhet të përgatisë elaborat të ri të shpronësimit dhe të aplikojë sërish për shpronësim, dhe më pas për kushte ndërtimore në MMPHI si parakusht për sigurimin e lejes.

Mos trajtimi i çështjeve pronësore para nënshkrimit të kontratës për renovimin e stadiumit dhe mungesa e komunikimit të duhur ndërinstitucional ka ndikuar në mos trajtimin e çështjes së shpronësimit me kohë. Si rezultat i kësaj, MKRS-ja ende nuk e ka përfunduar shpronësimin e pronave dhe bashkimin e tyre në një titullar.

3.1.3 Mangësitë gjatë aplikimit dhe pajisjen me lejet e ndërtimit

Një nga kriteret tjera që duhet përmbushur para fillimit të procesit të renovimit/rikonfigurimit të stadiumit deri te vënia në funksion e tij është pajisja me leje të ndërtimit.

MKRS-ja kishte bërë kërkesë për pëlqim mjedisor në nëntor të vitit 2019 (196 ditë pas nënshkrimit të kontratës) dhe e kishte siguruar atë në fund të dhjetorit të po të njëjtit vit nga MMPHI. Pëlqimi mjedisor është vetëm një nga kërkesat që duhet përmbushur dhe është kusht për sigurimin e kushteve ndërtimore dhe si e tillë nuk mjafton për nisjen e punimeve në stadium.

MKRS-ja është ende në fazat fillestare të përmbushjes së kërkesave për të aplikuar për kushte ndërtimore që është një hap para sigurimit të lejes ndërtimore, derisa kjo e fundit pa i përmbushur këto kritere ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka kontraktuar renovimin/rikonfigurimin e stadiumit. Kriteret të cilat MKRS-ja i ka përmbushur deri më tani për t'u pajisur me kushte ndërtimore janë pëlqimi mjedisor si dhe projekti ideor.

MKRS-ja nuk ka aplikuar ende për leje ndërtimore sepse nuk i plotëson kriteret për t'u pajisur me një leje të tillë. Një nga kërkesat ligjore për t'u pajisur me leje ndërtimore është që prona në të cilën kryhet ndërtimi duhet të ketë një titullar të pronës që në këtë rast kjo çështje nuk është zgjidhur ende.

Duke qenë se MKRS-ja ende nuk ka arritur të përmbush kërkesat për të aplikuar për leje ndërtimi, punët për renovimin e stadiumit olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë nuk kanë filluar dhe vazhdojnë të mbesin peng i lejes ndërtimore. Përveç kësaj, për shkak të mos zhvillimit të punimeve mirëmbajtja e tij për të mos degraduar mund të shkaktoj kosto shtesë.

3.1.4 Realizimi jo sipas planit dinamik

AK përmes menaxhimit të kontratës duhet të sigurohen që stadiumet janë sipas standardeve të përcaktuara nga UEFA dhe se pranimi i punëve bëhet bazuar në pozicionet e kontraktuara. Projektet e ndërtimit të stadiumeve duhet të përfundohen me kohë për të mundësuar zhvillimin e papenguar të aktiviteteve sportive

OE-ja kishte paraqitur fillimisht një plan dinamik për renovimin e stadiumit. Për arsye se inspektoriati në kuadër të MMPHI-së ia kishte ndaluar punën me kërkesë të inspektoriatit të Komunës së Mitrovicës, ky plan dinamik ishte rishikuar.

Sipas Organit Mbikëqyrës, puna nuk mund të zhvillohej sipas planit dinamik të propozuar për shkak të mungesës së lejes për kushte ndërtimore si dhe lejes së ndërtimit.

Për të adresuar këtë situatë, MKRS-ja në koordinim me OE-në në muajin shtator 2021 kishte bërë amendamentimin e kontratës për pjesën që i referohet afateve kohore për realizimin e projektit duke e shtyrë afatin e përfundimit deri në qershor të vitit 2023.

Foto 4. Gjendja aktuale e stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë



Deri në periudhën sa ne ishim në auditim⁹, MKRS-ja ende nuk kishte plotësuar parakushtet për të siguruar lejen ndërtimore dhe si rezultat i kësaj punët ndërtimore nuk kanë mundur të zhvillohen sipas planit dinamik për shkak se ato ishin ndërprerë nga Inspektorati i MMPHISË në muajin prill 2022.

Mos sigurimi i lejes së ndërtimit ka ndikuar që realizimi i punimeve mos të bëhet në përputhje me kontratën dhe planin dinamik e që ka rezultuar me vonesa të dukshme në fillimin e punimeve për renovimin e stadiumit. Si rezultat i mos sigurimit të lejeve të nevojshme deri më tani, shfaqet shqetësimi se përfundimi i plotë i projektit dhe funksionalizimi i tij nuk do të ndodhë brenda një periudhe optimale kohore. Kjo rrit rrezikun që Kombëtarja e Kosovës në futboll për shkak të ngarkesës të stadiumit të vetëm i cili i përmbush kriteret e UEFA-së të detyrohet që ndeshjet t'i zhvillojë në një shtet të rajonit. Po ashtu, kjo ndikon që edhe klubet sportive, tifozët dhe publiku i gjerë, ende të mos kenë mundësinë që të zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive dhe rekreative në këtë stadium.

⁹ Prill 2023

3.2 Faza e parë e renovimit të Stadiumit të Qytetit në Gjilan

Stadiumi i Qytetit të Gjilanit ishte ndërtuar në vitet e 70-ta dhe dikur gëzonte epitetin e një nga stadioneve me fushën më të mirë. Tani ky stadium nuk është në gjendje të mirëpres një nga ndeshjet më rivalizuese në futbollin e Kosovës, mes KF Gjilanit dhe KF Dritës, të dyja këto klube me renome në qytetin e Gjilanit si dhe në futbollin e Kosovës.

Me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit mes Komunës së Gjilanit dhe MKRS-së në vitin 2016, kishte nisur edhe zbatimi i projektit për renovimin e stadiumit të qytetit të Gjilanit. Për realizimin e këtij projekti, Komuna e Gjilanit ka qenë përgjegjëse për hartimin e projektit ideor, kryesor dhe zbatues, si dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për kontraktimin e kompanisë për ekzekutimin e punëve për renovimin e stadiumit, ndërsa MKRS-ja ka qenë e obliguar të sigurojë mjetet financiare.

Vlen të theksohet se për realizimin e projektit për renovimin e këtij stadiumi janë nënshkruar plot tre memorandume ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe MKRS-së.

Punimet janë ndërprerë zyrtarisht në gusht të vitit 2022, atëherë kur Komuna e Gjilanit kishte shkëputur kontratën me kompaninë e kontraktuar.

3.2.1 Mangësi në projektin ideor dhe kryesor

Projektet ideore si dhe kryesore duhet të hartohen para publikimit të njoftimit për kontratë konform kërkesave të ligjit për ndërtim si dhe udhëzuesit të UEFA-së për cilësi në stadione

Komuna e Gjilanit në fund të dhjetorit të vitit 2016, kishte kontraktuar kompaninë për hartimin e projektit ideor dhe kryesor për renovimin e stadiumit të qytetit sipas detyrës projektuese të dorëzuar nga komuna. Detyra projektuese e dorëzuar nga komuna nuk përmbante kategorizim të stadiumit fare edhe pse referencë kishte Udhëzues të UEFA-së për infrastrukturë dhe cilësi në stadione. Mirëpo sipas detyrës projektuese parashihet që stadiumi të ketë deri në 8,000 ulëse që sipas udhëzuesit të UEFA-së klasifikohet si stadium i kategorisë së dytë. Pas diskutimeve mes Komunës së Gjilanit dhe MKRS e cila kishte rezultuar me amendamentim të kontratës, stadiumi i qytetit në Gjilan me detyrë projektuese ishte klasifikuar në kategorinë e katërt, pasi që udhëzuesi i UEFA-s e parasheh që stadiumet me mbi 8,000 ulëse kategorizohen në kategorinë katër (duke plotësuar edhe kriteret tjera të nevojshme).

Po ashtu edhe në raportin e hartuar nga komuna në muajin korrik të vitit 2022 për konstatimin e gjendjes së punimeve në stadium theksohet se "projekti ideor dhe kryesor për renovimin e Stadiumit të Gjilanit kishte projektuar intervenime fizike ashtu që në fund të procesit, stadiumi i Gjilanit të certifikohet për kategori të dytë".

Vlen të theksohet se komuna nuk e kishte parë të arsyeshme që projektin ideor dhe atë kryesor ta dërgojë në MKRS dhe UEFA për ta diskutuar dhe vlerësuar nëse projekti i plotëson kriteret për t'u klasifikuar qoftë edhe për kategorinë e dytë, si dhe për të marrë rekomandimet për përmirësimet eventuale në projekt.

Diskutimet eventuale me përfaqësues të UEFA-së do të mund të ishin të dobishme për komunën për të përcaktuar kategorizimin e saktë të stadiumit dhe të evitonin problemet të cilat ishin shfaqur gjatë realizimit të projektit për shkak të kategorizimit të vonuar.

Në fund të tetorit të vitit 2017 komuna kishte lidhur kontratën për realizimin e punimeve ndërtimore me një afat prej 36 muaj. Punimet për renovim të stadiumit për kategori të dytë kishin filluar në nëntor të vitit 2017.

Foto 5 Gjendja aktuale në stadium të qytetit të Gjilanit



Dy vite më pas (dhjetor 2019), MKRS-ja kishte kërkuar që projekti kryesor t'i nënshtrohet aprovimit nga UEFA në mënyrë që i njëjti të marrë aprovimin nga ky i fundit për zhvillim të ndeshjeve ndërkombëtare, mirëpo projekti nuk ishte dorëzuar në UEFA nga komuna.

Punimet për renovimin e stadiumit të qytetit kishin vazhduar për 34 muaj (deri në shtator të vitit 2020) me një ritëm të ngadaltë dhe ndërprerje të shumta, fillimisht për shkak të gjendjes pandemike, pastaj për shkak të problemeve me cilësinë e projektit si dhe çështjeve pronësore.

Në shtator të vitit 2020 apo dy muaj para se të skadonte kontrata, komuna me rekomandim të MKRS-së kishte bërë amandamentim substancial të kontratës duke ndryshuar pozicionet në paramasë për të akomoduar realizimin e punimeve për stadium të kategorisë së katërt.

Me këtë rast nuk ishin marrë në konsideratë hapat e nevojshëm për ri-projektim për renovim të stadiumit, apo edhe tenderim të ri për realizimin e projektit për stadiumin e kategorisë së katërt meqenëse kjo implikon ndryshime substanciale në projekt.

MKRS-ja dhe Komuna e Gjilanit kishin filluar diskutimin për kategorizimin e stadiumit vetëm pasi kishin nisur punimet për renovim të stadiumit të qytetit. Për ndryshimet e bëra me amandamentim të kontratës Komuna nuk e kishte konsultuar ligjin për ndërtim lidhur me hapat që duhet të ndiqen meqë kategorizimi i ri (katërt) i stadiumit kishte ndryshime substanciale në projekt. Sipas menaxherit të kontratës, punët e realizuara janë bërë vetëm me detaje në baza ad-hoc të ripërpunuara nga kompania projektuese pa dokumentacion të rregullt e të plotë teknik.

Mos ri-projektimi për renovimin e stadiumit të qytetit të Gjilanit kishte bërë që komuna të hasë në vështirësi dhe dinamikë të zvogëluar të punimeve si dhe shtyrje të afatit të realizimit të punimeve përmes amandamentimit kohorë për dy vite. Kjo kishte rezultuar me ndryshime të theksuara të disa pozicioneve si dhe ndërprerje të kontratës dhe rikthim në pikën zero të procesit por që pjesët që janë paguar janë ndërtuar. Tani MKRS-ja ka marrë pronësinë e plotë mbi këtë projekt dhe ka filluar një proces të ri që nga hartimi i projektit ideor dhe kryesorë deri te realizimi përfundimtarë i tij. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme në projekt, ky stadium rrezikon që mos të licencohet për kategorinë e katër.

3.2.2 Mos trajtimi me kohë i çështjeve pronësore

Plani dinamik për renovim/rikonfigurim deri te vënia në funksion të stadiumit duhet të përfshijë një sërë aktivitetesh ose veprime paraprake. Të gjitha dokumentet relevante (lejet ndërtimore, mjedisore, elaboratet për shpronësim, certifikata e sigurisë në punë, etj.) të cilat ndërlidhen me fillimin e punës ndërtimore duhet të kompletohen me kohë në mënyrë që mos të shfaqen pengesa të panevojshme gjatë realizimit të punimeve.

Për projektin "Renovimi i stadiumit të qytetit të Gjilanit" kemi vërejtur se komuna nuk e kishte adresuar me kohë çështjen lidhur me shpronësimin e disa pronave rreth stadiumit të cilat kanë rol kyç në funksionalizimin e stadiumit. Kjo ka bërë që kontesti pronësor lidhur me një pronë private të pengoj shtrirjen e gypave të kanalizimit dhe atmosferik¹⁰ e që i kishte pamundësuar OE-së të realizojë punimet për një vit të tërë.

Sipas Menaxherit të Projektit, me finalizimin e projektit si tërësi do të paraqiten problemet në rregullimin e infrastrukturës përcjellëse për shkakun se lokacioni i gjerë përfshinë edhe disa parcela private e sidomos qasjen deri në stadium.

¹⁰ tani ky problem është pjesërisht i tejkaluar ku gypi është i kyçur në rrjetin e sistemit të kanalizimit dhe sistemit atmosferik të qytetit

Në kuadër të lokacionit të stadiumit janë shtatë parcela private të cilat kanë një hapësirë me rreth 53 ari. Katër parcela janë pjesërisht të zgjidhura ndërsa tri prej tyre presin të zgjidhen nga ana e Komunës.

Përveç kësaj, Komuna nuk i ka dhënë ende epilog procesit të zgjidhjes të hapësirave komunale që janë në shfrytëzim nga Drejtoria e Arsimit "kompleksi i shkollave të mesme" dhe që bien ndesh me projektin e Stadiumit të Qytetit por që në këtë fazë nuk është pengesë e punimeve.

Komuna nuk e kishte vlerësuar si prioritet çështjen e shpronësimit të pronave, sidomos ato që lidhen me qasjen në stadium. Kjo për shkak se sipas zyrtarëve të komunës punimet zhvilloheshin brenda stadiumit dhe ishin të fokusuar në fazën e parë të projektit.

Mos adresimi me kohë i çështjeve pronësore që kanë rolin kyç në funksionalizimin e stadiumit ka rezultuar me vonesa në realizim të projektit duke i pamundësuar kështu OE-së të vazhdojë me punimet në stadium. Vonesat në hapat e ndërmarrë nga Komuna në zgjidhjen e çështjeve të pronave private si dhe komunale që gjenden rreth lokacionit të Stadiumit, gjatë funksionalizimit të stadiumit mund të rezultojnë me probleme për krijimin e qasjes së duhur për hyrje në stadium. Këto vonesa mund të bëhen shkaktar që funksionalizimi i stadiumit të qytetit të prolongohet edhe më tutje edhe pas përfundimit të punimeve ndërtimore.

3.2.3 Mos respektimi i kriterëve për pajisje me kushte dhe leje adekuate ndërtimore

Në rastet kur ka ndryshime substanciale në projekt duhet të parashtrohet kërkesë e re për t'u pajisur me kushte ndërtimore si dhe leje të ndërtimit.

Komuna e Gjilanit kishte siguruar lejen ndërtimore nga Drejtoria komunale e Urbanizmit në shtator të vitit 2017 për renovimin e stadiumit të qytetit duke mos specifikuar kategorinë. Leja ndërtimore ishte siguruar dy muaj para nënshkrimit të kontratës për realizim të punimeve.

Komuna kishte bërë amandamentimin e kontratës për të akomoduar kërkesat për klasifikimin e stadiumit në kategori të nivelit të katërt sipas udhëzuesve të UEFA-së. Këtë e kishte bërë për t'i ikur nevojës për kthim të procesit në fillim për t'u pajisur me kushte dhe leje ndërtimore. Mirëpo, ndryshimi i kategorisë së stadiumit nënkupton ndryshime substanciale në strukturë andaj me ligjin për ndërtim kërkohet hartimi i projektit të ri e cila e rikthen procesin e pajisjes me kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore në pikën fillestare.

Komuna nuk e kishte parë të arsyeshme të ri-aplikoj për leje pasi që ajo e kishte siguruar një të tillë më herët dhe e kishte konsideruar si të përmbyllur këtë çështje. Planifikimi i dobët dhe menaxhimi jo i duhur kishte si pasojë mos pajisjen me leje adekuate të ndërtimit, e që kjo është një nga arsyet që ka rezultuar me ndërprerje të kontratës.

3.2.3 Ndryshime të konsiderueshme në disa pozicione të kontratës

Në interpretimin e KRPP-së që ka të bëjë me ndryshimet për zgjerimin e objektit të kontratës theksohet "Kurdo që ndryshimi i kontratës zgjeron në mënyrë të konsiderueshme objektin e kontratës me qëllim që të përfshihen më shumë sasi të furnizimeve, shërbimeve apo punëve shtesë, konsiderohet ndryshim thelbësorë dhe rrjedhimisht nuk lejohet. Në mënyrë të konsiderueshme ndryshohet objekti i

kontratës kur ndryshimet në kontratë tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës në rastin e kontratave publike për furnizim, shërbime dhe punë shtesë’.

Në kontratën për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjilan, nga krahasimet e bëra vërejmë se kishte diferenca në mes të vlerës së kontraktuar dhe asaj të realizuar, të cilat në hollësi mund të shihen në tabelën në vijim si për nga vlera ashtu edhe për nga përqindja:

Tabela 1 Diferenca në mes të vlerës së kontraktuar dhe të realizuar në euro

Nr i pozicionit	Vlera e Kontraktuar	Vlera e Realizuar	Diferenca	Diferenca në %
01	200	0	(200)	-100%
02	200	0	(200)	-100%
03	900	0	(900)	-100%
04	600	0	(600)	-100%
06	100	0	(100)	-100%
07	100	0	(100)	-100%
08	2,500	0	(2,500)	-100%
F017-1	29,750	23,075	(6,675)	-22%
F017-2	14,280	251,242	236,962	1659%
F017-3	8,330	157,871	149,541	1795%
F017-4	23,625	31,509	7,884	33%
F017-5	15,435	392,905	377,470	2446%
F017-6	7,875	17,538	9,663	123%
F017-7	5,249	0	(5,249)	-100%
F017-8	3,474	66,052	62,578	1801%
F017-9	1,587	32,138	30,550	1924%
TOTALI	114,205	972,330	862,725	755%

Nga analiza të cilën e kemi bërë në tabelën më lart vërejmë se në total vlera e kontraktuar për pozicionet e caktuara ishte 114,205€ ndërsa vlera e realizuar e ndryshuar me amandamentim për pozicionet e njëjta ishte 972,330€ që kishte rezultuar me një diferencë më të lartë prej 862,725€ apo 755%.

Këto diferenca tregojnë se ndryshimi i vlerës së kontraktuar përmes amandamentimit të kontratës është materialisht i lartë dhe sipas rregullave të prokurimit publik një gjë e tillë nuk lejohet. Kjo kishte ndodhur fillimisht për shkak të mos hartimit të duhur të projektit për renovimin e stadiumit i cili nuk kishte marrë parasysh gjendjen reale të tribunave në aspektin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë, si dhe amandamentimin e kontratës në masë të konsiderueshme. Si rezultat i kësaj janë realizuar punime të cilat kishin tejkalime enorme për pozicionet e caktuara të ndryshuara përmes amandamentimit krahasuar me ato të kontraktuara fillimisht.

Niveli i realizimit për fazën e parë ishte 71% dhe kontrata për këtë stadium është ndërprerë. Për vazhdimin e renovimit të këtij stadiumi tani ka filluar të merren MKRS dhe ajo ka kontraktuar hartimin e projektit ideor.

3.2.4 Oferta fituese më e shtrenjtë në realizim se ofertat tjera pas amendamentimit të kontratës

Duke u nisur nga fakti që kriter për dhënie të kontratës ishte çmimi më i ulët atëherë rrjedhimisht OE-ja fituese gjatë zbatimit të kontratës duhet të jetë me koston më të ulët.

Shikuar nga perspektiva e menaxhimit të prokurimit me rastin e nënshkrimit të kontratës duket se oferta fituese ishte oferta me koston më të lirë për AK-në.

Ne kemi analizuar nëse gjatë zbatimit të kontratës oferta fituese kishte rezultuar me kosto më të ulët në krahasim me ofertat e tjera të përgjegjshme dhe pjesëmarrëse në këtë procedurë. Në vijim kemi shpalosur analizën tonë:

Tabela 2 Diferenca në mes fituesit dhe OE-ve tjera në procedurë

Nr i pozicionit	Vlera Totale e kontratës bazë	Vlera totale e amendamentuar e kontratës	Vlera e ofertës së OE-së së pasuksesshëm	Diferenca
01	200	0	0	0
02	200	0	0	0
03	900	0	0	0
04	600	0	0	0
06	100	0	0	0
07	100	0	0	0
08	2,500	0	0	0
F017-1	29,750	23,075	12,361	10,713
F017-2	14,280	251,242	134,594	116,648
F017-3	8,330	157,871	84,574	73,297
F017-4	23,625	31,509	16,880	14,629
F017-5	15,435	392,905	210,485	182,420
F017-6	7,875	17,538	9,395	8,142
F017-7	5,249	0	0	0
F017-8	3,474	66,052	35,385	30,667
F017-9	1,587	32,138	17,217	14,921
Vlera totale e kontratës	3,121,346	3,979,470	3,759,790	219,680

Kur ky proces shikohet nga këndvështrimi i zbatimit të kontratës dalin rezultate krejtësisht të ndryshme, ku kostoja e punimeve të realizuara nga operatori fitues pas amandamentimit, në fund ka tejkaluar ofertat tjera¹¹.

Analiza jonë ka treguar se nga pesë ofertuesit tjerë të cilët kishin oferta të përgjegjshme kemi vërejtur se tre nga ata kanë rezultuar me oferta me vlerë më të ulët se sa oferta fituese pas amandamentimit të kontratës.

Kjo tregon se prokurimi nuk e ka arritur qëllimin e synuar, në lidhje me aspektin ekonomik dhe vlerën për parane e shpenzuar, pasi që Komuna e Gjilanit kishte paguar 219,680€ më shumë se sa do të paguante po të kishte bërë planifikim të duhur fillimisht.

3.3. Faza e parë për renovimin e Stadiumit të Qytetit në Gjakovë

Stadiumi i qytetit në Gjakovë është një simbol i rëndësishëm i sportit për këtë qytet. Ky stadium është përdorur kryesisht për zhvillimin e ndeshjeve të futbollit nga ana e klubit lokal KF Vëllaznimi. Stadiumi kishte një kapacitet të kufizuar të shikuesve si dhe kishte një infrastrukturë mjaft të dëmtuar andaj nevoja për investime kapitale ishte më se e domosdoshme.

3.3.1 Projekti nuk i plotëson kriteret për stadium të kategorisë së katërt

Projektet ideore si dhe kryesore duhet të hartohen para publikimit të njoftimit për kontratë konform kërkesave të ligjit për ndërtim si dhe udhëzuesit të UEFA-së për cilësi në stadione. Për stadione me kapacitet mbi 10,000 shikues, leja duhet të merret nga MMPHI, ndërsa për stadione me kapacitet nën 10,000 shikues leja sigurohet nga komuna përkatëse

Në muajin shkurt 2019, Komuna e Gjakovës kishte bërë hartimin e projektit për renovimin e stadiumit të qytetit me kapacitet rreth 12,000 ulëse. Në muajin maj 2019 komuna kishte lidhur memorandum bashkëpunimi me MKRS-në sipas të cilit ministria merr përsipër financimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për fazën e parë të projektit me vlerë 1,300,000€.

Me qëllim të realizimit të projektit komuna kishte aplikuar për sigurimin e kushteve ndërtimore në MMPHI pasi që për stadiumet mbi 10,000 ulëse kërkesa duhet të bëhet në ministri. Komuna ishte përpjekur që hartimin e projektit për stadiumin e qytetit ta bëjë për kategorinë e katërt sipas udhëzueseve të UEFA-së, mirëpo nuk kishte arritur të sigurojë kushtet ndërtimore nga MMPHI.

MMPHI kishte refuzuar kërkesën për dhënien e kushteve ndërtimore për shkak se dokumentacionit ndërtimorë të dorëzuar nga komuna i mungonin disa dokumente.

Vlen të theksohet se komuna dhe as MMPHI nuk e kishin dërguar projektin ideor dhe atë kryesor në UEFA për ta diskutuar dhe vlerësuar nëse projekti i plotëson kriteret për t'u

¹¹ Përveç OE-së së prezantuar në raport, në këtë procedure kishte 3 OE me çmime më të lira se OE fitues, për pozicionet e caktuara, por që ne kemi prezantuar vetëm ofertën më të lirë

klasifikuar për kategorinë e katërt, si dhe për të marrë rekomandimet për përmirësimet eventuale në projekt.

Si rezultat Komuna e Gjakovës është detyruar të zvogëloj numrin e ulëseve në stadium nën 10,000 më saktësisht 9,942 në mënyrë që kërkesa për kushte ndërtimore si dhe leje ndërtimore të bëhet në komunë. Si rrjedhojë në qershor të vitit 2020 Drejtoria për kulturë dhe sport në komunën e Gjakovës kishte aplikuar në drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për kushte ndërtimore, e cila brenda një muaji kishte miratuar kushtet ndërtimore.

Mangësitë që kanë përcjellë hartimin e projekteve ideore dhe kryesore, mungesa e dokumenteve të nevojshme si dhe refuzimi i kushteve ndërtimore nga ana e MMPHI kanë rezultuar me mos fillimin e punëve me kohë për renovim të stadiumeve, shtyrjen e afateve kohore për realizim të kontratave/projekteve apo edhe me zvogëlim të kategorisë nga katër në kategorinë e dytë.

Foto 6 Tribuna e stadiumit të qytetit të Gjakovës



3.3.2 Refuzimi i kërkesës për kushte ndërtimore në mungesë të dokumentacionit

Dokumentacioni për t'u pajisur me leje ndërtimi duhet të jetë i plotë dhe në pajtim me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi. Përveç dokumenteve tjera ato duhet të përfshijnë edhe: ekstrakti i dokumentit të planifikimit hapësinor të nivelit qendror dhe lokal, studimi i fizibilitetit për projektin në fjalë dhe studimi mbi makro-lokacionin.

Edhe pse Komuna e Gjakovës kishte aplikuar me kohë për kushte ndërtimore në MMPHI, nuk e kishte kompletuar dokumentacionin e nevojshëm. Në fund të muajit qershor 2019, Komuna e Gjakovës kishte aplikuar për leje të ndërtimit për projektin "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjakovës". Pas plotësisht një muaji, MMPHI-ja kishte kërkuar nga komuna që dokumentacioni ndërtimor të plotësohet me dokumente shtesë. Përfundimisht në fund të muajit nëntor 2019 apo pas pesë muajve ishte refuzuar kërkesa për kushte ndërtimore nga ana e MMPHI-së duke konstatuar se "dokumentacioni ndërtimor i aplikuesit për kushte ndërtimore të propozuara, është në kundërshtim me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi".

Dokumentet të cilat mungonin sipas MMPHI-së janë: ekstrakti i dokumentit të planifikimit hapësinor të nivelit qendror dhe lokal, studimi i fizibilitetit për projektin në fjalë dhe studimi mbi makro-lokacionin. Përveç kësaj MMPHI-ja kishte konstatuar se kushtet ndërtimore të propozuara nga komuna ishin në kundërshtim me Nenin 3 të ligjit për ndërtim i cili nuk e parasheh fjalën "Renovim" por "Rindërtim".

Mos sigurimi i kushteve ndërtimore ka ndodh për shkak se Komuna e Gjakovës nuk kishte arritur të përgatisë si duhet dosjen duke mos e plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm për të siguruar kushtet ndërtimore.

Kjo ka rezultuar me vonesa në fillimin e punëve për realizimin e projektit për renovimin e stadiumit si dhe në zhvillimin e punëve pa siguruar lejet e nevojshme paraprakisht.

3.3.3 Realizimi i planit dinamik jo i kënaqshëm

AK përmes menaxhimit të kontratës duhet të sigurohen që stadiumet janë sipas standardeve të përcaktuara nga UEFA dhe se pranimi i punëve bëhet bazuar në pozicionet e kontraktuara. Projektet e ndërtimit të stadiumeve duhet të përfundohen me kohë për të mundësuar zhvillimin e papenguar të aktiviteteve sportive

MKRS-ja në fillim të prillit të vitit 2020 kishte lidhur kontratën "Renovimi i stadiumit të qytetit të Gjakovës - Faza e parë". Sipas planit dinamik përfundimi i punimeve ishte paraparë të bëhej në afat prej 36 muaj nga nënshkrimi i kontratës apo në fillim të muajit prill 2023. Nga pagesat të cilat i kemi pranuar nga MKRS deri më tani (në muajin prill sa ishim në auditim) janë realizuar punë në vlerë 296,240€ apo 28% të vlerës së projektit. Në fund të muajit prill 2023, MKRS-ja kishte ka nxjerr vendim për zgjatjen e afatit për realizimin e punimeve deri në fund të vitit apo për 9 muaj.

Vonesa në realizimin e planit dinamik ishte rezultat i pandemisë si dhe pas pandemisë ndërpreja e punimeve ishte bërë nga OE-ja për shkak të ngritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore.

Mos realizimi i punimeve në përputhje me kontratën dhe planin dinamik ka rezultuar me vonesa të dukshme në përfundimin e projektit për renovimin e stadiumit si dhe funksionalizimin e plotë të tij. Me intensitetin e punimeve të realizuara deri më tani shfaqet shqetësimi se përfundimi i plotë i projektit dhe funksionalizimi i tij nuk do të ndodhë brenda një periudhe optimale kohore duke pasur parasysh se kjo është vetëm faza e parë e projektit.

3.4 Përdorimi shumë i shpeshtë i procedurave të negociuara të prokurimit nga MKRS

Për këto tri projekte ne kemi audituar pesë procedura të prokurimit (tri procedura për realizimin e punëve, një procedurë për hartimin e projektit dhe një procedurë për mbikëqyrjen e punëve). Nga këto procedura në tri raste kemi vërejtur se MKRS-ja kishte përdorur procedurën e negociuar duke i arsyetuar proceset si raste emergjente. I tërë projekti i renovimit të stadiumit olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë është konsideruar si emergjencë ekstreme, por që MKRS-ja nuk është treguar fare efikase në finalizimin e procedurës së negociuar, meqë i janë dashur gjashtë muaj për të përmbyllur procesin e prokurimit (nga inicimi i prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës). Kjo tregon mungesë të bazës për përdorim të procedurës së negociuar dhe është në kundërshtim me kriteret e nevojshme për të justifikuar përdorimin e kësaj procedure. Me këtë ishte dëmtuar transparenca dhe ishte kufizuar konkurrenca.

3.4.1 Arsyetimi i paqëndrueshëm i kriterit për përdorim të procedurës së negociuar

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit duhet të përdoret procedura më transparente dhe më konkurruese. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm pasi të përmbushen saktë kushtet e specifikuar në ligj të prokurimit.

MKRS-ja për procesin e prokurimit për renovimin e stadiumit olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë kishte përzgjedhur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, duke iu referuar kushtit të emergjencave ekstreme¹² që e parasheh Ligji për Prokurim Publik (LPP).

Departamenti i Sportit kishte kërkuar në fund të dhjetorit 2018 nga Departamenti i Prokurimit në kuadër të MKRS që për këtë aktivitet të prokurimit të shfrytëzohen procedurat e negociuara për shkak të afateve të ngushta kohore. Departamenti i Prokurimit kishte vendosur të përkrah përdorimin e kësaj procedure dhe i ishte referuar nenit të ligjit të prokurimit që mbulon emergjencat ekstreme sa për të përmbushur kërkesën ligjore.

¹² Neni 35.2.1 (iii) i ligjit për prokurim publik

Ky kusht duhet të dokumentohet në mënyrë të plotë dhe të përfshihet në arsyetim për përdorim të procedurës së negociuar. Sipas ligjit, nëse rrethanat që krijuan situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues, atëherë ky kusht nuk mund të shfrytëzohet.


Zyra e Prokurimit në MKRS ishte arsyetuar se afatet e përcaktuara nga UEFA për zhvillimin e garave plotësonin mjaftueshëm kushtin e emergjencës ekstreme.

Megjithatë, ky arsyetim nuk ishte i qëndrueshëm aq sa për të justifikuar përdorimin e procedurës së negociuar në këtë rast, duke e bërë procesin e prokurimit jo transparent dhe në kundërshtim me parimin e LPP-së, kur bëhet fjalë për përdorimin e procedurës së negociuar.

Renovimi i një stadiumi nuk ka si të kategorizohet si emergjencë ekstreme sidomos nëse përmbyllja e këtij procesi të prokurimit kishte zgjatur rreth 6 muaj nga iniciimi i kërkesës deri në kontraktim (nga dhjetori i vitit 2018 deri në qershor të vitit 2019). Sidomos nëse kësaj i shtohet fakti që për realizim të punimeve me kontratë ishin paraparë edhe 24 muaj (730 ditë kalendarike) për realizim të punimeve. Apo edhe fakti që jemi në vitin 2023 dhe MKRS ende nuk ka siguruar parakushtet që ishin të domosdoshme të sigurohet para fillimit të procesit të prokurimit.

Grafiku 2 më poshtë tregon se për renovimin e stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë, procedura e negociuar kishte zgjatur 179 ditë kalendarike, ndërsa procedura e hapur e ndjekur nga Komuna e Gjilanit ishte përfunduar për 163 ditë apo 16 ditë më herët se ajo e negociuar (emergjente) nga MKRS. Edhe procedura e hapur për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjakovë do të përmbyllej në një afat prej 187 ditëve që është i përafërt me procedurat e negociuara për stadiumin Adem Jashari, mirëpo nënshkrimi i kontratës për shkak të ndryshimeve në qeveri ishte vonuar për rreth tre muaj.

Grafiku 2 Kohëzgjatja e procedurave të prokurimit në tri stadiumet e audituara



Procedura e negociuar e prokurimit si procedurë më pak transparente kishte rezultuar me një numër prej vetëm tre ofertuesve. Kjo kishte rezultuar në trajtim të pa barabartë/diskriminim

të ofertuesve potencial. Përdorimi i procedurës së hapur do të mundësonte numër më të madh të ofertave e cila përveç çmimeve më të lira do të mund të sillte konkurrencë më të madhe.

Fillimisht Komuna e Gjilanit kishte zhvilluar procesin e prokurimit për renovimin e stadiumit të qytetit në Gjilan duke përdorur procedurën e hapur si procedurë më transparente. Mirëpo për shkak të problemeve me projektin ideor dhe kryesor komuna kishte ndërprerë kontratën. Ndërprerja e kontratës kishte bërë që i gjithë procesi të rikthehet në pikën zero. Me këtë rast MKRS kishte marrë pronësinë e plotë mbi këtë projekt dhe ka filluar një proces të ri që nga hartimi i projektit ideor dhe kryesor deri te realizimi përfundimtar i tij.

MKRS-ja për procesin e prokurimit për hartimin e projektit për renovimin e stadiumit në Gjilan kishte përzgjedhur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, duke iu referuar kushtit të emergjencave ekstreme që e parasheh Ligji për Prokurim Publik (LPP).

MKRS-ja menjëherë pas shkëputjes së kontratës në muajin gusht 2022 kishte bërë iniciimin e procesit prokurimit duke përdorur procedurën e negociuar. Kjo procedurë ka rezultuar e pasuksesshme pasi që ofertat e OE-ve ishin të papërgjegjshme. Kërkesa për ri-tenderim ishte bërë në fillim të nëntorit duke e përdorur sërish procedurën e negociuar e cila ka rezultuar me nënshkrimin e kontratës në muajin dhjetor.

Zyra e sekretarit të përgjithshëm në kuadër të MKRS-së i ishte drejtuar Departamentit të Prokurimit që për këtë aktivitet të prokurimit të shfrytëzohen procedurat e negociuara duke përdorur arsyetimet për shkëputje të kontratës si shkak për këtë procedurë dhe nevojën urgjente për ndërtimin e një stadiumi alternativ. Departamenti i Prokurimit kishte vendosur të përkrah përdorimin e kësaj procedure dhe i ishte referuar nenit të ligjit të prokurimit që mbulon emergjencat ekstreme sa për të përmbushur kërkesën ligjore.

Procedura e negociuar e prokurimit si procedurë më pak transparente kishte rezultuar fillimisht me dështim të procesit dhe paraqitjes së nevojës për ritenderim e cila kishte shkaktuar vonesa për rreth pesë muaj. Vlen të theksohet se në ritenderim kishte ofertuar vetëm një OE e cila edhe ishte shpallur fitues. Përdorimi i procedurës së hapur do të mundësonte numër më të madh të ofertave e cila përveç çmimeve më të lira do të sillte konkurrencë më të madhe. Kjo kishte rezultuar në trajtim të pa barabartë/diskriminim të ofertuesve potencial. Përveç kësaj, edhe në këtë rast rezulton se përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të jetë i paqëndrueshëm, pasi që kontraktimi nuk po kryhet më shpejtë se tek procedura e hapur. Komuna e Gjakovës nuk kishte përdorur procedurën e negociuar.

[3.4.2 Vazhdim i përdorimit të procedurës së negociuar edhe për kontratën për punë mbikëqyrëse](#)

MKRS-ja në muajin dhjetor të vitit 2019 kishte nënshkruar kontratën për mbikëqyrje profesionale të punëve për renovimin e stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë në vlerë prej 185,000€. Kjo kishte ndodhur 192 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës bazë për renovim të stadiumit. Sikurse te kontrata bazë edhe në këtë rast ishte përdorur procedura

e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Gjatë kësaj periudhe, OE-ja për zbatimin e kontratës bazë ishte angazhuar plot gjashtë muaj në hartimin e projektit ideor për stadium, gjatë së cilës MKRS-ja kishte mundësi të zhvillonte procedurë të hapur për kontraktimin e Organit Mbikëqyrës.

Edhe për këtë kontratë, Zyra e Prokurimit në MKRS iu ishte referuar afateve kohore të përcaktuara nga UEFA për të argumentuar përdorimin e procedurës së negociuar. Në të njëjtën kohë, Zyra e Prokurimit në MKRS i ishte referuar kërkesës së nenit që flet për mbrojtjen e pronës intelektuale për të mbështetur përdorimin e procedurës së negociuar.

Sikurse në rastin e kontratës për renovim të stadiumit, Departamenti i Sportit kishte kërkuar nga Departamenti i Prokurimit në kuadër të MKRS që për këtë aktivitet të prokurimit të shfrytëzohen procedurat e negociuara për shkak të afateve të ngushta kohore. Departamenti i Prokurimit kishte vendosur të përkrah përdorimin e kësaj procedure ashtu siç ishte arsyetuar nga njësia kërkuese.

Procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë do të duhej të përdoren si burim i fundit meqë nuk sigurojnë transparencë dhe konkurrencë aq sa procedura e hapur. Nëse kjo procedurë praktikohet në shumë kontrata, mund të ndikojë në kosto më të larta të projekteve, zvogëlimin e konkurrencës dhe shmangien e ofertave më të mira nga OE-të.

3.4.3 Hulumtimi i tregut

Zyrtarët përgjegjës kishin njohuri se si përcaktohen kostot për ndërtimin e një stadiumi. Kostoja për ndërtimin e një stadiumi të futbollit matet me ulëse dhe kompleksitetin e stadiumit.

MKRS (Departamenti i Sportit) hulumtimin e tregut për kontratën e renovimit të stadiumit olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë e kishte bazuar në analiza për ndërtim të pjesshëm të stadimeve të cilat i kishte kryer një kompani e huaj (informata publike dhe jo të kontraktuara nga MKRS) për 10 stadime me kosto më të ulët për ulëse.

Bazuar në këto të dhëna të organizatave të specializuara, vlerësimi i koston për një stadium të ngjashëm me këto tri stadime që po ndërtohen në Kosovë (në kohën e kontraktimit) sillet rreth 1,100 deri 1,500 euro për ulëse. Kontratat për të tri stadiumet e audituara silleshin rreth kësaj vlere. Prandaj nisur nga këto edhe mund të llogaritet që është bërë hulumtim i pranueshëm i tregut.

3.5 Mangësi tjera që kanë përcjellë proceset administrative

Gjatë auditimit të tri projekteve për renovim të stadiumeve në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë kemi vërejtur edhe disa mangësi që kanë përcjellë zhvillimin e këtyre projekteve

3.5.1 Zyrtar i njëjtë caktohet anëtar i komisionit të vlerësimit si dhe menaxher i kontratës

Një zyrtar i cili ka qenë anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të caktohet menaxher i kontratës.

rregulla dhe udhëzuesi operativ për prokurim publik thekson se "Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit". Ne kemi vërejtur se për tenderin "Renovimi i stadiumit të qytetit të Gjakovës - Faza e Parë" MKRS-ja kishte caktuar zyrtarin e njëjtë si anëtar i komisionit të vlerësimit të tenderit dhe i njëjti ishte caktuar menaxher i kontratës.

Po ashtu edhe për tenderin "Rikonstruimi i stadiumit të qytetit në Gjilan" komuna e kishte caktuar zyrtarin e njëjtë i cili kishte marrë pjesë edhe në procesin e vlerësimit të tenderit edhe në pozitën e menaxherit të kontratës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos kushtimit të kujdesit të duhur nga ana e MKRS si dhe të Komunes së Gjilanit me rastin e nxjerrjes së vendimeve për anëtarë të komisionit të vlerësimit dhe menaxher të kontratës.

Caktimit i zyrtarit i cili ka qenë anëtar në komisionin e vlerësimit edhe në pozitën e menaxherit të kontratës është në kundërshtim me rregullat e prokurimit dhe paraqet konflikt interesi. Ndarja jo e duhur e detyrave rritë rrezikun që të mos ketë kontrolle të mjaftueshme dhe si pasojë të shfaqen mangësi në realizimin e punëve sipas kontratës.

3.5.2 Mos ri-konfirmimi i informatave financiare në Deklaratën e Nevojave

Personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale.

Ne kemi vërejtur se në dy raste (për renovim të stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë dhe për mbikëqyrje të punimeve për këtë stadium) "Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve nuk ishte plotësuar si duhet. Kjo për arsye se mungonin nënshkrimet e nevojshme të zyrtarëve përgjegjës tek pjesa e cila ka të bëjë me ri-konfirmim të fondeve (Neni 3 Shqyrtimi). Pra, MKRS-ja nuk kishte ri-konfirmuar nëse informatat financiare, kishin ndryshuar në mënyrë substanciale apo jo, para publikimit të nënshkrimit të kontratës.

Në pyetjen tonë për mos nënshkrim të kësaj deklarate, MKRS-ja në përgjigjen e ofruar nuk specifikon qartë shkakun e mos nënshkrimit të saj, mirëpo jepen disa sqarime lidhur me

ndarjet buxhetore rreth projektit për renovimin e stadiumit olimpik "Adem Jashari". Ndërsa për kontratën për mbikëqyrje të punimeve në stadium nuk ka dhënë sqarime.

Mos ri-konfirmimi i informatave financiare nga personat përgjegjës rrezikon që MKRS-ja të hyjë në obligime kontraktuale në mungesë të fondeve të nevojshme për të mbuluar shpenzimet për realizimin e projektit apo të paraqesë vështirësi financiare që ndikojnë në realizimin e projektit sipas dinamikës së paraparë.

3.5.3 Projektet për investime kapitale ishin ndesh me njëra tjetrën

Komuna e Gjilanit kishte hartuar projektin ideorë dhe kryesorë për renovimin e stadiumit të qytetit. Ndërkohë komuna kishte hartuar edhe projektin për ndërtimin e sheshit mbi lumin Mirusha i cili gjendet pranë stadiumit të qytetit. Ky projekt bie ndesh me projektin për renovimin e stadiumit të qytetit për shkak se e kufizon qasjen për hyrjen e veturave në parkingun e stadiumit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos koordinimit midis drejtorive komunale gjatë hartimit të projekteve ideore dhe kryesore për këto dy projekte.

Mos koordinimi ka rezultuar që projekti i realizuar për ndërtimin e sheshit të ndërhyj në pjesën e projektit për renovimin e stadiumit e cila parasheh hyrjen për vetura në stadium. Për të funksionalizuar projektin e stadiumit, komuna do të detyrohet të demoloj një pjesë të sheshit për të cilën ishin investuar mjete financiare. Ndeshja e projekteve ka ndikuar që komuna të ketë humbje financiare në njërin anë si dhe shkaktimin e vonesave në funksionalizimin e stadiumit në anën tjetër.

4 Konkluzionet

MKRS së bashku me Komunit (Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë) nuk ishin efikase në realizimin e projekteve për renovimin e stadiumeve. Edhe pse kanë kaluar disa vite (prej katër deri në shtatë vite) që nga fillimi i procesit për renovimin e stadiumeve ato ende nuk kanë përfunduar si dhe sipas gjendjes në terren ato ende janë larg përfundimit dhe funksionalizimit.

Mos fillimi i punëve me kohë për renovim të **stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë** dhe shtyrja e afateve kohore për realizim të kontratës/projektit, ishte si rezultat se projekti ideor nuk ishte hartuar në kohën e duhur sipas fazave të parapara me udhëzues. **MKRS** kishte përdorur kushtet e FIDIC-ut të cilat parashohin përfshirjen e projektit ideor në kontratën bazë të renovimit të stadiumit. Për shkak se projekti ideor nuk ishte hartuar në fazën e duhur sipas udhëzuesve të UEFA-së, kishte shkaktuar vonesa edhe në parashtrimin e kërkesës fillimisht për shpronësim, kushte ndërtimore e më pas edhe për leje ndërtimore.

Mos kategorizimi me kohë i **stadiumit të qytetit në Gjilan**, ka ndikuar që të ketë amandamentim të kontratës e rrjedhimisht edhe ndryshime substanciale për të përshtatur realizimin e punimeve për kategori të katërt. Ndryshimet e bëra me amandamentim krahasuar me kontratën bazë ishin deri në 75% për pozicione të caktuara. Këto ndryshime kishin bërë që Komuna e Gjilanit të paguaj 219,680€ më shumë se sa do të paguante sikur këto ndryshime t'i inkorporonte që nga fillimi. Ky ndryshim në çmim është llogaritur mes OE-së fituese dhe OE-së së përgjegjshëm por të pasuksesshëm. Këto ndryshime përveç që nuk lejohen me rregullat e prokurimit publik, tregojnë edhe që identifikimi i nevojave për këtë projekt ishte larg nevojave reale dhe Komuna nuk kishte arritur vlerë për para. Kjo ishte edhe si pasojë se detyra projektuese nuk ishte e detajuar mjaftueshëm për të reflektuar kategorinë që pritet t'i takojë ky stadium.

Projekti ideor dhe kryesor për **stadiumin e qytetit në Gjilan** do të duhej t'i nënshtrohej aprovimit të UEFA-së para nënshkrimit të kontratës për realizim të punimeve. Përveç faktit që një gjë e tillë nuk kishte ndodhur para nënshkrimit të kontratës, kërkesa nga **MKRS** për aprovim nga UEFA ishte bërë tek dy vite pas nënshkrimit të kësaj kontrate. Pra ky projekt ishte kontraktuar pa pasur siguri se stadiumi do të licencohet nga kjo e fundit.

Përveç mos respektimit të kërkesave sa i përket kategorizimit të stadiumit dhe projektit ideor dhe kryesor, **Komuna e Gjilanit**, nuk kishte respektuar as kërkesat ligjore për ndërtim. Komuna kishte siguruar leje për kategorinë e dytë, ndërsa stadiumi në ndërtim ka qëllim të jetë i kategorisë së katërt, pra që nënkupton ndryshime substanciale në strukturë. Me ligjin për ndërtim kërkohet hartimi i projektit të ri i cili e rikthen procesin e pajisjes me kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore në pikën fillestare. Pra mos pajisja me leje të re rrezikon që ky stadium edhe po të përfundohet në përputhje me kriteret për kategorinë e katër mund të mos arrijë të licencohet.

Hartimi i projektit për **stadiumin e qytetit në Gjakovë**, në mungesë të dokumenteve të nevojshme të kërkuara me ligjin e ndërtimit ka rezultuar me zvogëlimin e numrit të ulëseve

dhe kategorisë së stadiumit. Hartimi jo adekuat i projektit, mungesa e dokumenteve të nevojshme si dhe refuzimi i kushteve ndërtimore nga ana e MMPHI-së ka rezultuar me uljen e kategorisë së stadiumit nga niveli i katër në kategorinë e tretë sipas udhëzuesve të UEFA-së, e cila njëkohësisht ka shkaktuar vonesa në realizimin e projektit. Ky projekt është në fazën fillestare të realizimit.

Problemet me shpronësimin e parcelave me ndërmarrjen "Trepça" ishin ngritur qysh në fillim të zbatimit të kontratës për rinovim të **stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë**, por ato nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrë të duhur. Procesi i shpronësimit nuk ka përfunduar dhe ende gjendet në fazën fillestare. Kjo kishte krijuar pengesa për vazhdimin e punimeve në stadium dhe ishte një prej arsyeve kryesore që kishte ndikuar në mos realizim të projektit për një periudhë rreth pesë vite. Ngjashëm kishte ndodhur edhe në projektin për renovimin e **stadiumit të qytetit të Gjilanit** ku mos adresimi me kohë i çështjeve pronësore ka rezultuar me vonesa në realizim të projektit duke i pamundësuar kështu OE-së të vazhdojë me punimet në stadium. Këto janë shkaktar që funksionalizimi i stadiumit të qytetit prolongohet edhe më tutje.

Kriter për t'u pajisur me lejet të ndërtimit është edhe që procesi i shpronësimit të jetë i përfunduar. Renovimi i **stadiumit olimpik "Adem Jashari"** ka filluar pa u siguruar leja e ndërtimit. **MKRS-ja** nuk kishte marrë të gjitha veprimet e nevojshme që të aplikojë për leje ndërtimi me kohë dhe para fazës së tenderimit. Mungesa e lejes ndërtimore ka bërë që punimet në renovimin e stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë të ndërpriten nga inspektorati i MMPHI-së dhe të mos mund të fillojnë ende edhe pas më shumë se katër vitesh pas nënshkrimit të kontratës. Kjo mund të ndikojë që të shkaktohen kosto shtesë për mirëmbajtjen e gjendjes së stadiumit që të mos të degradohet edhe më tej.

Përdorimi i procedurës së negociuar ishte i panevojshëm, pasi që iu janë dashur gjashtë muaj nga fillimi i procedurës deri te nënshkrimi i kontratës bazë për realizim të punëve. MKRS-ja para marrjes së vendimit për përdorimin e procedurës së negociuar nuk kishte analizuar mjaftueshëm të gjitha rrethanat apo arsyet se pse procedura e hapur nuk mund të aplikohet. Paraqitja si raste emergjente nuk kishte bazë të mjaftueshme për shkak se renovimi i stadiumeve për nga natyra nuk mund të klasifikohet si emergjencë ekstreme. Pra MKRS, në rastin e **stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë**, përveç që nuk është treguar efikase, ka përdorur një procedurë më pak transparente dhe e cila nuk siguron konkurrencë të mjaftueshme. MKRS kishte përdorur procedurën e negociuar për tri kontrata: realizimi i punimeve dhe mbikëqyrja e tyre në stadiumin olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë dhe hartimi i projektit për stadiumin e qytetit në Gjilan.

Dinamika e punimeve në përgjithësi ishte e ulët. Projekti për renovimin e stadiumit olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë, ka ngecje në punime për arsye të mos sigurimit të kushteve paraprake të nevojshme për ndërtim. Stadiumi i qytetit në Gjilan ka përfunduar diku rreth 70% e fazës së parë të projektit, por për shkak të mos caktimit me kohë të kategorisë, është amandamentuar kontrata, janë tejkualuar pozicionet e caktuara dhe rrjedhimisht punët janë ndërprerë dhe kontrata është shkëputur. Ndërsa dinamika e realizimit të projektit për renovimin e stadiumit të qytetit të Gjakovës - Faza e parë ka qenë shumë e ulët, ku brenda

afatit prej 36 muajsh ishte realizuar vetëm 28% e vlerës së kontraktuar të projektit. Ky intensitet i ulët ishte si shkak i pandemisë fillimisht dhe ndryshimeve në çmime më pas. Me hyrjen në fuqi të një vendimi të Qeverisë, për subvencionimin e çmimeve në vlerë 30%, OE ka rritur intensitetin e kryerjes së punimeve.

Kombëtarja e Kosovës në futboll edhe për një periudhë kohore do t'i zhvilloj ndeshjet në stadiumin e vetëm i cili i përmbush kriteret e UEFA-së për kategorinë e katërt. Nëse renovimi i këtyre tri stadiumeve vazhdon me këtë intensitet dhe duke e pasur vetëm një stadium që i përmbushë kriteret, atëherë Kombëtarja e Kosovës, mund të ndodhë që ndeshjet t'i zhvillojë në një shtet të rajonit. Përveç kësaj kjo ndikon që edhe klubet sportive, tifozët dhe publiku i gjerë, ende të mos kenë mundësinë që të zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive dhe rekreative në këto stadiume.

Me mangësi të ndryshme ishin përcjellë edhe zhvillimi i procedurave të prokurimit në të tria projektet. Caktimi i zyrtarit të njëjtë si anëtar i komisionit vlerësues dhe menaxher i kontratës, mos konfirmimi i informatave financiare dhe mos koordinimi mes drejtorive të ndryshme për planifikim të projekteve, përveç që janë në kundërshtim me kërkesat për menaxhim të duhur financiar, këto paraqesin edhe rrezik për konflikt interesi, rrezik për hyrje në obligime financiare pa mbulesë dhe kosto shtesë kur projektet bien ndesh me njëra tjetrën.

5 Rekomandimet

Për të siguruar se projektet të cilat iniciohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve së bashku me Komunat e Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës janë në përputhje me kërkesat e udhëzuesve të UEFA-së, kërkesat ligjore në fuqi, në përputhje me kushtet në terren, zbatohen plotësisht dhe pa sfida, përfundohen me kohë si dhe arrijnë vlerë për paranë e shpenzuar, rekomandojmë të katër institucionet që:

- Projektet ideore hartohen në kohën e duhur sipas fazave të parapara me udhëzues të UEFA-së për cilësi në stadiume dhe kërkesave ligjore kombëtare për ndërtim;
- Projektet ideore të hartuara dërgohen paraprakisht për rishikim në UEFA për të pranuar rekomandimet për ndryshimet eventuale në mënyrë që stadiumet të licencohen nga kjo e fundit kur të përfundohen;
- Gjatë hartimit të detyrës projektuese specifikohet qartë kategorizimi i stadiumit sipas udhëzuesve të UEFA-së, në mënyrë që mos të ketë nevojë për ndryshime të mëvonshme;
- Të gjitha dokumentet relevante duke filluar nga: lejet mjedisore, elaboratet për shpronësim, kushtet ndërtimore dhe lejet ndërtimore kompletohen me kohë dhe para inicimit të kërkesës për fillimin e procedurave të prokurimit për renovimin e stadiumeve;
- Me rastin e aplikimit për sigurimin e kushteve ndërtimore dosja me dokumentacionin e nevojshëm të jetë e kompletuar në mënyrë që të mos vije deri te refuzimi i kërkesës dhe shkaktimi i vonesave për realizimin e projekteve;
- Para marrjes së vendimit për përdorimin e procedurës së negociuar janë analizuar mjaftueshëm të gjitha rrethanat, janë vlerësuar mundësitë për procedurë të hapur dhe atëherë kur nuk ka bazë as nevojë për përdorimin e saj, të përdoret procedura e hapur si procedurë më konkurruese;
- Bëhet analizë e detajuar për identifikimin e nevojave për realizimin e punimeve dhe të njëjtat të përfshihen në projekt me kohë. Në rastet kur hasen nevoja për ndryshime substanciale nga projekti bazë, të inicohet procedurë e re e prokurimit dhe rrjedhimisht të lidhet kontratë e re në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të ketë mbikëqyrje më aktive gjatë realizimit të punëve për të rritur intensitetin e punimeve dhe për të evituar pengesat në mënyrë që realizimi i punimeve të kompletohet sipas planit dinamik;
- Janë shtuar kontrollet gjatë marrjes së vendimeve për anëtarë të komisionit të vlerësimit dhe menaxher të kontratës, plotësisht të informatave financiare nga personat përgjegjës tek Deklarata e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Mjeteve si dhe me rastin e hartimit të projekteve të ndryshme për investime kapitale të ketë koordinim sa më të mirë midis departamenteve/drejtoreve në mënyrë që projektet të mos bien ndesh njëra me tjetrën.

Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Motivi i auditimit

Një infrastrukturë sportive me standarde të mira nënkupton që stadiumet të jenë cilësore, të ofrojnë siguri dhe mundësi për mbarëvajtje të aktiviteteve sportive dhe zhvillim të sportistëve dhe sportit në arenën ndërkombëtare. Mirëpo, jo çdo herë janë ofruar kushte të tilla me rastin e renovimit të infrastrukturës sportive.

Si pasojë e mos renovimit dhe ndërtimit me kohë të objekteve sportive, Kombëtarja e Kosovës në futboll për gati dy vite (2016-2017) duhej të udhëtonte 262 kilometra për në qytetin verior të Shqipërisë (Shkodër) për të zhvilluar ndeshjet si vendas, pasi që në Kosovë nuk ekzistonte asnjë stadium i cili përmbushte standardet e përcaktuara nga UEFA/FIFA. Kjo ka shkaktuar shpenzime shtesë për buxhetin e vendit. Edhe pse ishte rinovuar në vitin 2018 stadiumi “*Fadil Vokrri*” i cili i plotëson kriteret e UEFA/FIFA-së për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare, rrezikon të humbë licencën për shkak se është tejet i ngarkuar me zhvillimin e ndeshjeve të shpeshta në të dhe po të ndodhte një gjë e tillë, Kombëtarja e Kosovës sërish do të duhej t’i zhvillojë ndeshjet në ndonjë vend të rajonit.

Nga intervistat e zhvilluara me zyrtarët përgjegjës në MKRS si dhe në komuna¹³ kemi mbledhur dokumente dhe informacione në bazë të të cilave kemi identifikuar disa mangësi duke filluar nga problemet pronësore, definimi i projektit ideor, mungesa e projektit kryesorë, mungesa e lejes ndërtimore, zhvillimi i procedurave të prokurimit, vonesa në realizimin e punëve dhe dobësi në menaxhimin e kontratave.

Për të forcuar më tepër bindjet rreth problemeve në renovimin/rikonstruktimin e stadiumeve, në raportet¹⁴ e ndryshme ndër të tjera theksohet se Kosova ka arritur përparim të kufizuar në përmirësimin e infrastrukturës sportive sipas standardeve të UEFA/FIFA.

Një tregues tjetër që dëshmon mangësi në këtë fushë është edhe degradimi i stadiumeve e që do të kenë nevojë për riparim dhe mirëmbajtje më të shpeshtë se që është planifikuar.

Pyetjet e auditimit

Për t’iu përgjigjur objektivës së auditimit, kemi formuluar pyetjet dhe nën-pyetjet në vijim:

1. Sa ishin efikase Ministria dhe Komunitat në renovimin/rikonfigurimin e stadiumeve?
 - 1.1 A janë hartuar si duhet projektet ideore si dhe kryesore?
 - 1.2 A janë siguruar lejet e ndërtimit dhe a është aplikuar me kohë?
 - 1.3 A janë bërë shpronësimet dhe cilat janë veprimet e ndërmarra?
 2. A është zhvilluar procesi i prokurimit në mënyrë të duhur?
 - 2.1 A janë përdorur procedurat transparente të prokurimit?

¹³ Komunitat e Mitrovicës, Gjilanit dhe Gjakovës

¹⁴ Zyra për Planifikim Strategjik - Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030

2.2 A është bërë hulumtimi i tregut sipas kërkesave të LPP-së?

3. A është bërë menaxhimi dhe monitorimi i projekteve sipas kushteve të kontraktuara?

3.1 A janë realizuar punët sipas planit dinamik, nëse jo cilat janë rreziqet e mundshme?

A janë bërë punë jashtë kontratës? Nëse po, a janë arsyetuar dhe a ka qenë e mundur të parashikohen paraprakisht?

Kriteret e auditimit:

Kriteret e auditimit që kanë shërbyer për vlerësimin e objektivës së paraparë për këtë auditim janë bazuar në Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik si dhe literaturën e përgatitur për menaxhim të ndërtimit, praktikat e mira dhe standardet e UEFA-së për infrastrukturë të Stadioneve.

Për të verifikuar këtë, kemi vënë kriteret e përmbledhura:

- Ministria dhe Komunat duhet të jenë efikase në mënyrë që të arrijnë atë që kanë synuar në renovimin/ rikonfigurimin e stadioneve.
- Plani dinamik për renovim/ rikonfigurim deri te vënia në funksion të stadiumit duhet të përfshijë një sërë aktivitetesh ose veprime paraprake. Të gjitha dokumentet relevante (lejet ndërtimore, mjedisore, elaboratet për shpronësim, certifikata e sigurisë në punë, etj.) të cilat ndërlidhen me fillimin e punës ndërtimore duhet të kompletohen me kohë në mënyrë që mos të shfaqen pengesa të panevojshme gjatë realizimit të punimeve¹⁵;
- Projektet ideore si dhe kryesore duhet të hartohen me kohë konform kërkesave të ligjit për ndërtim para publikimit të njoftimit për kontratë;
- Që një stadium të jetë i pranueshëm dhe cilësor duhet që në paramasë të përfshihen të gjitha kërkesat e standardeve të aplikueshme. Do të thotë që projektit duhet t'i paraprijë një projekt ideor i detajuar dhe se i njëjti duhet të përmbushë kërkesat që dalin nga Rregullat e UEFA-së për Infrastrukturë të stadioneve¹⁶;
- Projektet duhet të përfundohen brenda çmimeve të kontraktuara dhe vlerësimi i nevojave duhet të jetë i bazuar në çmimet e tregut dhe çmimet konkurruese. Gjatë zhvillimit të aktiviteve të prokurimit të përdoret procedura më transparente dhe më konkurruese¹⁷;
- AK përmes menaxhimit të kontratës duhet të sigurohen që stadiumet janë sipas standardeve të përcaktuara nga UEFA dhe se pranimi i punëve bëhet bazuar në pozicionet e kontraktuara; dhe
- Projektet e ndërtimit të stadioneve duhet të përfundohen me kohë të planifikuar për t'iu mundësuar zhvillim të papenguar të aktiviteve sportive¹⁸.

¹⁵ Guide to quality stadiums – UEFA Edition 2011

¹⁶ UEFA Stadium Infrastructure Regulations – Edition 2018

¹⁷ REGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK Neni 4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit Pika 4.2 nën c)

¹⁸ Guide to quality stadiums – UEFA Edition 2011

Metodologjia e Auditimit

Metodologjia e auditimit kishte përfshirë metoda të kryerjes së auditimit të cilat janë elaboruar më poshtë në detaje, për të konkluduar nëse po arrihet efikasiteti në ndërtimin/renovimin e stadiumeve. Për të siguruar që informatat dhe analizat që dalin nga ky auditim janë të sakta dhe të dobishme, është konsideruar e nevojshme që të fokusohemi në krijimin e një dizajni të mirë të auditimit i cili do të shpie në adresimin e mangësive të mundshme.

Qasja jonë për auditimin e renovimit/ rikonfigurimit të stadiumeve përdor një varg teknikash për të marrë dëshmi dhe siguri të auditimit, ndër to janë: intervistimi i zyrtarëve përkatës, analizimi i dokumenteve relevante dhe ekzaminimet fizike të projekteve. Më konkretisht do të fokusohemi në:

- Analizimi i dokumentacionit (detyra projektuese) që lidhet me hartimin e projekteve ideore dhe kryesore.
- Intervistimin e zyrtarëve përgjegjës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe në komunat e përzgjedhura për procesin e hartimit të projekteve.
- Analizimi i dokumenteve për matjen e parcelës ku do të ndërtohet, analizimi i dosjes së konkursit të projektimit dhe analizimi i projektit ideor dhe kryesor. Analizimi i lejeve të ndërtimit dhe krahasimi i tyre me kërkesat sipas ligjit për ndërtim dhe ndërmarrje publike.
- Analizimi i elaborateve për shpronësim si dhe kërkesat për leje ndërtim.
- Krahasimi i ditarit ndërtimor të punëve me situacionet e përfunduara sipas afateve kohore të planit dinamik.
- Analizimi i elaborateve për shpronësim si dhe kërkesat për leje ndërtim.
- Intervistimin e zyrtarëve përgjegjës në Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe në komunat e përzgjedhura për procesin e ndërtimit/renovimit të stadiumeve.
- Analizimi i dokumenteve për matjen e parcelës ku do të ndërtohet, analizimi i dosjes së konkursit të projektimit dhe analizimi i projektit ideor dhe kryesor. Analizimi i lejeve të ndërtimit dhe krahasimi i tyre me kërkesat sipas ligjit për ndërtim dhe ndërmarrje publike.
- Krahasimi i planit të prokurimit me kontratën e nënshkruar, analizimi i dosjes së tenderit duke përfshirë njoftimin për tender, njoftimin për dhënie të kontratës dhe kontratën së bashku me paramasën dhe parallogarinë.
- Krahasimin e ditarit ndërtimor të punëve me situacionet e përfunduara sipas afateve kohore të planit dinamik.


- Testimin e pagesave për punët e bëra dhe krahasimi i tyre me kontratën, me fokus të veçantë në kohëzgjatje dhe shumën e kontraktuar.
- Analizimin e raporteve të pranimit të punëve si dhe krahasimi me gjendjen reale në terren. Qëllimi i këtyre vizitave është që të konstatojmë se deri ku kanë arritur punimet.
- Krahasimin e ditarit ndërtimor të punëve me situacionet e përfunduara sipas afateve kohore të planit dinamik.
- Testimin e pagesave për punët e bëra dhe krahasimin e tyre me kontratën e nënshkruar.
- Krahasimin e informatave në planin e menaxhimit të kontratës me punët në terren, krahasimin e raportit të pranimit të punëve me punët e përfunduara. Krahasimi i raporteve të menaxherëve të kontratave me paramasën dhe paralogarinë dhe me pagesat. Ekzaminimi në terren i projekteve të përzgjedhura si mostër.
- Analizimin e vlerësimeve të çmimeve të tregut, e vlerësimit të nevojave dhe specifikacioneve teknike. Janë analizuar nëse në parashikimin e vlerës së kontratës janë marrë parasysh çmimet e tregut lokal; dhe/ose - çmimet e kontratave paraprake të nënshkruara nga autoriteti i njëjtë apo tjetër kontraktues; dhe/ose - çmime ndërkombëtare të publikuara.

Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant

Infrastruktura sportive në Kosovë me theks të veçantë stadiumet e futbollit ndahen në katër kategori. Kategoria e katërt përfshinë stadiumet në të cilat lejohet zhvillimi i ndeshjeve në arenën ndërkombëtare të rangut më të lartë dhe janë nën administrimin e MKRS-së.

MKRS-ja është përgjegjëse dhe ka ndikim të madh në aspektin e ndërtimit/renovimit të infrastrukturës sportive në përgjithësi e stadiumeve të futbollit në veçanti pasi që është rregullator, prokurues dhe mbikëqyrës i projekteve të infrastrukturës sportive sipas standardeve të UEFA/FIFA.

Diagrami 1: Akterët përgjegjës në procesin e ndërtimit të infrastrukturës sportive në nivelin qendror dhe lokal



Definimi i projektit

Faza e definimit të projektit paraqet procesin e përgatitjes së dokumentit që zyrtarisht konfirmon projektin dhe Autoritetit Kontraktues (AK-së) i jep autoritet të përdorë burimet e organizatës për zhvillimin e aktiviteteve për realizim të projektit. Në rastin e ndërtimit të infrastrukturës sportive-stadiumit dokumenti që zyrtarisht e konfirmon projektin është ligji i buxhetit për vitin përkatës. MKRS përveç projekteve që i ka planifikuar vet në bazë të strategjisë për investim në sport, evidenton edhe projektet e reja që vijnë nga propozimet e deputetëve me rastin e amendamentimit të ligjit të buxhetit në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa, komuna planifikimin për investim në ndërtimin e infrastrukturës sportive e bënë bazuar në kërkesat e qytetarëve, ndërsa pas aprovimit të projekteve në Kuvendin Komunal fillohet me planifikim për kontraktim. Investimi në infrastrukturën sportive në Komuna është i fokusuar kryesisht në mirëmbajtje ose investime me vlera të vogla për shkak të buxhetit të kufizuar, ndërsa për investime me vlera më të mëdha kërkojnë mbështetje nga niveli qendrorë. Procesi i ndërtimit/renovimit të stadiumeve bëhet përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit (MM) në mes të MKRS-së dhe komunave, ku zakonisht komunat kryejnë procedurat e prokurimit, ndërsa ministria bën pagesat dhe cakton një zyrtar për mbikëqyrje të projektit.

Planifikimi

Planifikimi është një nga fazat më të rëndësishme të projektit e që shumica e proceseve zhvillohen përgjatë kësaj faze. Suksesi i kësaj faze është që të definohet qartë plani i menaxhimit të projektit i cili definon qartë gjithë punën e projektit. Në procesin e ndërtimit të infrastrukturës sportive, pas aprovimit të projekteve në ligjin e buxhetit, Departamenti i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS) në kuadër të MKRS-së si njësi kërkuese i paraqet kërkesat për projektet e aprovuara në departamentin e prokurimit që të përfshihen në planin final të prokurimit. Ekzistojnë raste kur MKRS-ja i'a beson udhëheqjen e procedurave të prokurimit Komunes ku është paraparë ndërtimi i stadiumit. Po ashtu, në komuna Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport (DKKRS) si njësi kërkuese i paraqet kërkesat për projektet e aprovuara në drejtorinë e prokurimit që të përfshihen në planin final të prokurimit. Për projektet e reja të aprovuara me ligj të buxhetit që nuk kanë projekt kryesor kërkohet hartimi i projektit, gjë që bëhet me procedurë të hapur tenderuese.

Organizimi

Faza e organizimit nënkupton ndarjen e detyrave karshi burimeve në dispozicion. Në rastet kur AK-ja nuk ka projekt ekzistues ajo bënë kontraktimin e kompanive projektuese. Kompania projektuese e punon projektin kryesor sipas detyrës projektuese dhe kushteve të kontratës. Projektin e hartuar e kontrollon dhe e aprovon komisioni i caktuar me vendim të sekretarit të përgjithshëm në nivelin qendror dhe kryetari i komunës në nivelin lokal. Pas aprovimit të projektit kryesor zyrtarët e njërive kërkuese përgatisin specifikacionet teknike në përputhje me projektin e aprovuar. Pas përgatitjes së specifikacionit teknik, njësia kërkuese përgatit kërkesën për inicim të procedurave të prokurimit. Divizioni/Drejtoria e Prokurimit i zhvillon procedurat e prokurimit publik dhe e përzgjedh OE fitues dhe nënshkruan kontratën.

Mbikëqyrja

Faza e mbikëqyrjes së procesit apo ekzekutimit, monitorimit dhe kontrollit, është një proces që ndërlidhet me ekzekutimin e projektit. Qëllimi i gjithë kësaj faze shumë të rëndësishme për realizimin me sukses të projektit dhe konform standardeve është që të kontrollohet dhe monitorohet progresi i projektit në raport me planin dhe në momente të caktuara kur të jetë e nevojshme të ndërhyhet për eliminimin/parandalimin e problemeve. Sipas ligjit të prokurimit, menaxhimit dhe mbikëqyrjen e realizimit të punimeve e bën menaxheri i kontratës si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Në rastet kur ka projekte komplekse AK-të përmes procesit të prokurimit publik angazhojnë kompani të specializuara për mbikëqyrje.

Pranimi


Kjo fazë nënkupton përmbylljen e procesit në tërësi dhe pranimin e punëve. Në këtë fazë është e nevojshme përgatitja e një liste kontrolluese për t'u siguruar nëse projekti është realizuar sipas kontratës. Në nivel qendror pranimi i punëve bëhet nga komisioni i formuar me vendim të sekretarit të përgjithshëm, ndërsa në nivelin lokal me vendim të kryetarit të komunës formohet komisioni për pranimin e punëve.

Shtojca 2. Letër konfirmimet



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Vendi dhe data: Mitrovica e Jugut , datë 27/07/2023

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


Kryetari i Komunes:


z. Bedri Hamza





KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjiilan dhe Gjakovë”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Gjiilan, 27.07.2023

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjiilan dhe Gjakovë”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Alban Hyseni
Kryetar i Komunës së Gjiilanit





Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
 Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
 Ministry of Culture, Youth and Sport



Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

08.08.2023
 Prishtinë, Republika e Kosovës

LETËR KONFIRMIMI

Mbi të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës "Renovimi dhe rikonfigurimi i stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë", dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese konfirmoj se kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit mbi auditimin e performancës "Renovimi dhe rikonfigurimi i stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë". Duke e vlerësuar punën në hartimin e raportit, pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna. Sa i përket rekomandimeve për rastet specifike që adresohen në raport, MKRS veç është në proces të adresimit të tyre.

Deri tash kemi ndërmarrë hapa drejt zgjidhjes, si më poshtë, që do të reflektohen hollësisht në planin e veprimit:

- **Stadiumi i Gjilanit**

- Pas shkëputjes së kontratës paraprake nga Komuna e Gjilanit, MKRS ka marrë përsipër udhëheqjen e procesit të këtij stadiumi dhe ka hartuar specifikacionet teknike të hollësishme për zhvillimin e projektit ideor dhe zbatues për stadium të kategorisë 4 sipas standardeve të UEFA;
- MKRS ka udhëhequr procedurën tenderuese për zhvillimin e projektit ideor dhe zbatues për stadiumin e Gjilanit me kategori 4 sipas standardeve të UEFA, dhe është vlerësuar operatori fitues nga komisioni përkatës;
- MKRS, përmes stafit përgjegjës, ka mbikëqyrur mbarëvajtjen e kontratës së operatorit ekonomik të përzgjedhur për hartimin e projektit ideor dhe zbatues, ku gjatë procesit të hartimit të projektit zbatues, MKRS bashkë me të gjitha palët përgjegjëse janë në konsultim të vazhdueshëm me persona të licencuar

nga UEFA për plotësimin e të gjitha standardeve të nevojshme për kategorinë e përcaktuar me kërkesë;

- Sipas kufijve të përcaktuar konform standardeve nga projekti i hartuar, në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit ka filluar hartimi i elaboratit të shpronësimit për pronat që nuk janë në pronësi publike.

- **Stadiumi "Adem Jashari", Mitrovicë**

- Sipas projektit të hartuar nga operatori ekonomik i kontraktuar në vitin 2019, MKRS ka filluar të trajtojë problemin pronësor, ku tashmë është hartuar elaborati i shpronësimit dhe përmes kërkesës së MKRS ka filluar procedura e shpronësimit për të gjitha parcelat brenda kufijve të projektuar të stadiumit "Adem Jashari" të cilat nuk janë nën pronësi të plotë publike.
- Në koordinim me MMPHI, janë përbushur të gjitha kërkesat ligjore për diskutimin publik ndërsa MMPHI ka dorëzuar kërkesën në Zyrën e Kryeministrit për vendimin preliminar si hap i radhës si përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

- **Stadiumi i Gjakovës**

- Gjatë vitit të fundit, stafi përgjegjës në MKRS është angazhuar duke ndërmarrë të gjitha masat dhe duke përdorur të gjithë mekanizmat procedural për dinamizim të punës në terren, që ka rezultuar pa sukses. Në këtë rast, MKRS është obliguar të ndërmarrë hapat e nevojshëm kontraktual për shkëputje të kontratës me marrëveshje të palëve;
- MKRS ka formuar ekipin i cili do të shërbejë si komision përgjegjës për evidentimin e gjendjes në terren konform procedurave teknike zbatuese dhe administrative sipas kontratës, që do të rezultojë me gjendjen faktike të saktë të kontratës aktuale.

Brenda 30 ditëve të pranimit të raportit final do të dorëzojmë planin e veprimit përfshirë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.


Hajrulla Çeku
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Republika e Kosovës



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmëri në të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për Raportin e Auditimit të Performancës **“Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 27.07.2023

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Renovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë”** (në tekstin e mëtejshëm **“Raporti”**);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- Komuna e Gjakovës ka dorëzuar në kohë projektin në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për procedurat tjera tenderuese.

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini
Ardian Gjini





Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



Zyra Kombëtare e Auditimit | Lagjja Arbëria | Rr. Ahmet Krasniqi, 210 | 10000 Prishtina
Republika e Kosovës